

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: Autoritetin Kontraktues Ministria e Mbrojtjes

Për Aktivitetin e Prokurimit: 217-22-7705-1-1-1

Sa i përket tenderit për: *RITENDER - Furnizim me Çizme ushtarake*“ për nevoja të FSK-së

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SOLID ShPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Zona Industriale Suharekë

(Adresa)

Suharekë

23000

(Vendi)

(Kodi postar)

044113393

n/a

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Shefqet Kuçi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

solidshpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

Solid sh.p.k.
Shefqet Kuçi



18.12.2023

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vlerë)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Isuf Zejna

(Emri i avokatit)

Rruga Fehmi Agani nr. 138/5, Prishtinë

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

RITENDER - Furnizim me Çizme ushtarake“ për nevoja të FSK-së

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapje elektronike

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kemi dorëzuar kërkesë për rishqyrtim me datë 04.12.2023, por e njëjta është refuzuar me datë 08.12.2023, pa i trajtuar pretendimet ankimore, me përgjigje të shkurtra se thjeshtë nuk qëndron pretendimi ankimor. Niveli i ulët i kujdesit në trajtimin e pretendimeve ankimore, tregon për qasje diskriminuese të autoritetit kontraktues, jo vetëm në shqyrtim të ofertës, por edhe të mjeteve juridike, kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji i Prokurimit Publik

- Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 67 - Provat Shkresore
- Neni 70 - Standardet për Sigurimin e Cilësisë
- Neni 131 - Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

- Neni 26 – Grupi i Operatorëve Ekonomik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjorbë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. HYRJE

- 1.1. Autoriteti Kontraktues Ministria e Mbrojtjes (tutje referuar si: “**Autoriteti Kontraktues**”) me datë 29.11.2023 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (tutje referuar si: “**Vendimi i Kundërshtuar**”) me anë të të cilit ofertën e Solid ShPK (tutje referuar si: “**Ankuesi**”) e ka refuzuar kinse si të

papërgjegjshme dhe ka rekomanduar për dhënie të kontratës grupin e operatorëve ekonomik Runway ShPK dhe Genc Taahhut Giyim Tekstil Insaat San. Ve. Tic. LTD (tutje referuar si: **“I rekomanduari për kontratë”**).

- 1.2. Ankuesi menjëherë ka dorëzuar Kërkesë për Rishqyrtim brenda afateve të parapara me LPP dhe atë me datë 04.12.2023, pranë Autoritetit Kontraktues me anë të së cilës e ka kundërshtuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për shkak se i njëjti është i kundërligjshëm për arsyet e poshtëshënuara:
 - a) *Testimi i mostrave është bërë në Laborator pa akreditim ndërkombëtar për testim të lëkurës dhe Autoriteti Kontraktues nuk ka kontratë me këtë laborator.*
 - b) *Operatori i rekomanduar për dhënie të kontratës është i papërgjegjshëm pasi që nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit.*
 - c) *Autoriteti kontraktues nuk ka ofruar informata sipas Nenit 10 të Ligjit se si ka përzgjedhur laboratorin për testim të artikujve.*
- 1.3. Autoriteti Kontraktues me datë 08.12.2023 ka nxjerr vendim me të cilin ka bërë refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, me anë të të cilit vetëm ka konstatuar se pretendimet e Ankuesit janë të pabazuara por, nuk ka marrë mundin ti arsyetoj ato. Në këtë Vendim, nuk është sqaruar as procedura përmes të cilit mostrat janë dërguar në laboratorin përkatës dhe as informatat nëse i njëjti ka apo jo akreditim përkatës ndërkombëtar.
- 1.4. Që të gjitha pretendimet ankimore janë refuzuar me arsyetime të përgjithshme dhe pa referenca në prova dhe dispozita përkatëse ligjore, prandaj Ankuesi e shfrytëzon të drejtën e dorëzimit të kësaj ankese, pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), me të njëjtat pretendime ankimore.

II. TESTIMI I MOSTRAVE TË ÇIZMEVE U BË NË LABORATOR PA AKREDITIM NDËRKOMBËTAR DHE PA MARRËVESHJE LIGJORE ME MINISTRINË

- 2.1. Autoriteti Kontraktues ka përzgjedhur pa asnjë bazë ligjore një laborator në Shqipëri përkatësisht Universitetin Politeknik të Tiranës, Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës. Në vet Raportin e Testimit thuhet: *“Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës është i akredituar nga Drejtoria e Akreditimit, Tiranë Sipas S SH ISO/IEC 17025:2017”*. Nga ky sqarim është e kuptueshme se ky laborator ka thjeshtë licencë kombëtare në Republikën e Shqipërisë dhe nuk posedon asnjë akreditim ndërkombëtarë nga ana e Organizatës Ndërkombëtare të Testimeve, IAF, WAS apo të Komitetit Evropian të Standardeve. Rrjedhimisht asnjë garanci nuk ekziston se ky laborator ka akreditim ndërkombëtar për të kryer testimet e kërkuara sipas vendimit të OSHP. Përderisa ky Laborator nuk mund të dëshmoj se ka akreditim për kryerjen e testimeve të tilla është e pakuptueshme se si i njëjti mund ti nxjerr rezultatet e ndryshme për lëkurën e njëjtë e cila është testuar në laborator ndërkombëtar evropian (Shihni të bashkangjitura kopjet e raporteve të testimit të materialeve). Po ashtu produktet e SOLID të dorëzuara si mostër pranë AK, janë testuar si të tilla në laboratorin MakKontrol në Maqedoni të Veriut për çka mund ti referoheni Raportit me numër 5527A/22 dhe 5526B/22 i datës 17.10.2022.
- 2.2. Autoriteti Kontraktues nuk do të duhej që testimin e mostrave për një aktivitet të prokurimit kaq të ndjeshëm ta dërgoj në një laborator i cili edhe në të kaluarën është

përfshirë në raste të ngjashme të testimëve të dyshimta, kur për të njëjtat produkte ka dorëzuar rezultate të ndryshme për ne dhe të tjera për autoritetin kontraktues (Shih Vendimin e OSHP me numër PSH.nr.155-170/18).

- 2.3. Në kuadër të qasjes në dokumente zyrtare kemi kërkuar edhe marrëveshjen me këtë laborator dhe akreditimin e Laboratorit i cili i ka kryer testimin dhe Autoriteti Kontraktues është përgjigjur se të njëjtën nuk mund ta ofroj përmes zyrës së prokurimit dhe na ka rekomanduar ti drejtohem zyrës për komunikim me publikun. Po ashtu edhe kësaj zyre i jemi drejtuar dhe nuk kemi pranuar asnjë përgjigje. Nga të dhënat në platformën e eProurimit nuk kemi gjetur asnjë kontratë me ndonjë laborator e cila është lidhur në përputhje me Ligjin. Për këtë arsye, kemi dyshim se asnjë marrëveshje e ligjshme nuk ekziston me këtë laborator për të kryer testimet e kërkuara sipas Vendimit të OSHP-së. As licenca e vitit 2017 e cila përmendet në këtë raport të testimin nuk është më tutje valide, pasi që e njëjta kishte afat 5 vjeçar. Po ashtu ky laborator nuk ka asnjë akreditim as kombëtar dhe as ndërkombëtar për testimin e shojës së çizmes e cila prodhohet nga goma dhe TR, dhe jo lëkura.
- 2.4. Në Nenin 26 paragrafi 6 i Rregullores së Prokurimit Publik kërkohet që standardet e cilësisë në rast të grupit të operatorëve ekonomik të plotësohen nga të gjithë anëtarët e konsorciumit, pasi që në këtë nen thuhet: *“Çertifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse.”* Lideri i konsorciumit nuk ka asnjë ISO Standard të plotësuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit, andaj oferta e operatorit të rekomanduar për kontratë nuk plotëson Nenin 70 të Ligjit dhe Nenin 26 të Rregullores. Në rastin konkret asnjëri nga anëtarët e konsorciumit nuk është prodhues i çizmeve dhe në këtë rast nuk janë plotësuar kërkesat e cilësisë sipas kërkesave ligjore.
- 2.5. Asnjë nga ISO standardet e prodhuesit nuk janë të lexueshme dhe verifikueshme online, për shkak të kualitetit të dobët të skenimit të dokumentit dhe Autoriteti Kontraktues nuk e ka marrur mundin që ti verifikoj ato me prodhuesin dhe me institucionin i cili i ka lëshuar këto certifikata.
- 2.6. Ne si operator prodhues në anën tjetër kemi paraqitur të gjitha certifikatat dhe testet e produktit, dhe të njëjtat jemi të gatshëm që me shpenzimet tona ti dërgojmë në cilindo laborator me renome ndërkombëtare apo evropiane për testim. Në këtë mënyrë autoriteti kontraktues do të bindej se çizmet e prodhuara nga Solid janë të kualitetit më të lartë nga të gjitha ofertat e dorëzuara.

III. OPERATORI I REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS ËSHTË I PAPËRGJEGJSHËM PASI QË NUK PËRMBUSH KËRKESAT E DOSJES SË TENDERIT.

- 3.1. Marrëveshja e konsorciumit në mes të anëtarëve nuk i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit, pasi që e njëjta nuk i ka elementet e kërkuara sipas Dosjes së Tenderit, nuk ka deklaratë se të gjithë anëtarët personalisht dhe bashkarisht janë përgjegjës për zbatimin e kontratës, mungon deklarata se anëtarët nuk aplikojnë individualisht

në ndonjë konsorcium tjetër për të njëjtin aktivitet të prokurimit si dhe mungon autorizimi dhe deklarata për autorizim të liderit të grupit për konsorciumit për këtë aktivitet të prokurimit. Dokumenti i dorëzuar nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe Ligjit të Prokurimit Publik.

- 3.2. Nga qasja në dokumente kemi vërejtur se Operatori i rekomanduar nuk ka dorëzuar kërkesat e përshtatshme përkatësisht a. Vendimi i gjykatës, b. Vërtetimet tatimore dhe 3. Konfirmimet bankare. Tek të rekomanduarit për kontratë mungojnë informatat e biznesit, certifikata e TVSH-së dhe ajo e numrit fiskal. Në Vendim për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues pretendon se i ka ato, mirëpo është e evidente se të njëjtat ose nuk janë dorëzuar ose nuk na janë dhënë përmes qasjes në dokumente.
- 3.3. Dokumentet e dëshmisë së qarkullimit në vlerë prej 4,000,000 Euro nuk janë dëshmuar me raport bankar, apo raport tjetër të besueshëm. Deklaratat e tatimeve kinse të përkthyer janë të paqarta dhe Autoriteti Kontraktues, nuk ka sqaruar me çfarë kursi të këmbimit i ka kalkuluar ato vlera për të ardhur deri tek konkluzioni se plotësohet kushti i qarkullimit financiar. Vlera aktuale e këmbimit të valutës turke është 31 Lira për 1 Euro, andaj konsiderojmë se i njëjti nuk e arrin në asnjë mënyrë të dëshmoj qarkullimin apo qarkullimin specifik të kërkuar sipas dosjes së tenderit. Sipas llogaritjeve tona, qarkullimi specifik i të rekomanduarit arrin në vlerën 1.9 milion Euro dhe kështu nuk arrin kërkesën për 3 milion Euro.
- 3.4. I rekomanduari për kontratë nuk e ka sistemin e lidhjes së shpejtë për mbathjet dhe lëvizjet siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe kjo vërehet me vet katalogun e dorëzuar dhe fotografitë në te. Për më tepër ka dallime në mes të lidhëseve të prezantuara në katalog dhe në mostrat e dorëzuara ku në katalog thuhet se ato janë të rrafshta ndërsa në fotografitë e mostrës shihet se të njëjtat janë të rrumbullkta.
- 3.5. Hi (nga prodhimi i çizmes) është kërkuar maksimalisht të jetë 9 % sipas standardit EN ISO 4047:1998. Operatori i rekomanduar e ka ofruar 9.5 sipas EN ISO 4047;1998.
- 3.6. Tek çizmet dimërore, materiali i epërm është kërkuar pesha të jetë min. 300 g/2 ±15%, ndërsa është ofruar Quality analysis for Lining fabric for uppers Weight | 360 g/m². Pra kërkesa e dosjes së tenderit nuk është respektuar pasi që pesha e produktit e tejkalon limitin për devijim 15%. Vërejtje tjetër dhe shumë serioze në lidhje me këtë operator është se nuk ka katalog të vetin, por ka kopjuar (copy dhe paste) kërkesat e dosjes së tenderit.

IV. AUTORITETI KONTRAKTUES NUK KA OFRUAR INFORMATA SIPAS NENIT 10

- 4.1. Me kërkesën për qasje në dokumente është kërkuar edhe marrëveshja me laboratorin i cili ka kryer testimet si dhe qasja në mostrat e produkteve të ofruara. Autoriteti Kontraktues ka dështuar që të jap qasje në të dy këto kërkesa, duke u arsyetuar se nuk i kanë marrë mbresa mostrat e produkteve dhe se nuk mund ta ofrojnë marrëveshjen me laboratorin, por e njëjta duhet të kërkohej tek zyra për informim. Nga ana e OSHP-së kërkojmë që të kërkoj qasje në këtë marrëveshje, të shoh nëse e njëjta është e ligjshme dhe nëse laboratori ka akreditimin e duhur ndërkombëtar për këto shërbime.

4.2. Një qasje e tillë është në kundërshtim me Nenin 10 të Ligjit të Prokurimit Publik dhe vet Ligjin për Qasje në Dokumente Publike Neni 11 [Trajtimi i kërkesave për qasje në dokumentet publik] në të cilin thuhet: “Kërkesat për qasje në dokumente publike apo për ripërdorim të dokumenteve publike trajtohen nga cilido institucion publik që posedon dokumentin publik të kërkuar.” Në rastin konkret Departamenti i Prokurimit nuk ka pasur të drejtë të kërkojë që dokumenti të kërkohej tek departamenti tjetër, pasi që kjo kërkesë vetëm sa ka ndikuar që dokumenti të mos sigurohet brenda afatit për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim.

4.3. Duhet theksuar se po i njëjti autoritet kontraktues në dy procese të vlerësimit na ka shpallur si kompani e përgjegjshme në dy procese të ndara të vlerësimit paraparak të këtij tenderi. Prandaj, si është e mundur që në të njëjtin aktivitet të prokurimit, me të njëjtat mostra ky autoritet kontraktues të arrij rezultate të vlerësimit diametralisht të ndryshme nga vlerësimi i parë dhe i dytë.

Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha argumentet e lartcekura me respekt i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që të nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazar Ankesa e operatorit ekonomik Solid ShPK të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Fatos Zeqiri me seli në Prishtinë, Rruga Fehmi Agani nr. 138/5 Prishtinë, kurse Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 29.11.2023 **ANULOHET** dhe lënda kthehet në komision për **RIVLERËSIM**.
- II. **OBLIGOHET** Autoriteti Kontraktues që në afat prej 10 ditësh, ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
- III. **LEJOHET** të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.